



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 392/prot.
2

Peshkopi, më 27.12.2024

VENDIM

Nr. 28 Datë 27.12.2024

PËR

“MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT DIBËR PËR VITIN 2025”

Në mbështetje të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 77 pika “ç”, neni 83, Ligji nr 7961, datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës si Republikës së Shqipërisë” me ndryshime Ligji nr 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, VKM nr 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punësnë institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, VKM nr. 503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime ne VKM nr 328, dt 31.05.2023” Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njërive të vetëqeverisjesvendore”. VKM Nr. 421, datë 26.06.2024 ” Për disa ndryshime ne VKM nr 325, dt 31.05.2023 ”Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike “, Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 27.12.2024, pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës dhe të nivelit e pagave të personelit të Këshillit të Qarkut Dibër” me 9 (nente) vota pro,

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Dibër për vitin 2025, emërtimet e drejtorive, sektorve dhe pozicionet e punës, klasifikimin e pozicioneve të punës, klasifikimin e pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil si dhe nivelin e pagës për cdo pozicion, sipas tabelave 1 dhe 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Sektori I Çështjeve Ligjore
3. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e Ligjshmërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
5. U shpall me dt. 27.12.2024.

KRYETAR

Alma Selami

